

Doj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES

Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 22 23 10 e-mail: info@Durrës.gov.al

Nr 5146 Prot

Durrës më, 12/9 /2009

KONTRATË PËR SHERBIME KONSULENCE

"Projekt zbatim rruge paralel me murin rrethues te Portit"

Nr. References se Kontrates: BD.SH.K.16.09

Lidhur ndërmjet palëve

Bashkise Durrës "Autoriteti Kontraktor"

Dhe

AVE CONSULTING "Kontraktuesi"

Bashkia Durrës

1

AVE CONSULTING

KONTRATË
“Projekt zbatim rruge paralel me murin rrethues te Portit”
Nr i referencës BD.SH.K.16.09

Kjo marrëveshje (Kontratë) nënshkruhet sot më datë 16 . 11 . 2009 Durrës ndërmjet dy palëve:

“Autoriteti Kontraktor” **Bashkia Durrës**
Adresa : Sheshi “Iliria”, Qyteti Durrës
Tel /fax: 052 22 23 10
NIPT : K42006501R
Përfaqësuar nga Kryetari Bashkise z. Vangjush **DAKO**

Dhe

“Kontraktuesi” **AVE CONSULTING**
Adresa : Rr.Kavajes, nr.116, Qendra Gurten Tiranë
Tel /Fax: 04 2259552 / 0682055463
NIPT : K 81321002 M
Përfaqësuar nga Administratori z. Arben **DERVISHAJ**

Neni 1 - Baza ligjore

Kontrata mbështetet në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit, ligji nr. 8652 date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2- Përbërja e kontratës

2.1 Kontrata do të përbëhet nga dokumentet e mëposhtëme dhe dokumentat të tjera të tenderit te dates 04.08.2009 me nr reference BD.SH.K.16.09 duke përfshirë KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit si dhe aneks kontrata per termat e references.

- Formulari i Kontratës i nënshkruar nga palët me dokumentat e tenderit të cilësuar në të.
- Sigurimi i kontratës në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e garancisë lëshuar nga shoqëri sigurimi .
- Oferta sipas detyres se projektimit ne dokumentat e tenderit me propozimin teknike dhe ekonomike te paraqitur nga Kontraktuesi ne tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor .

2.2 Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës ne dokumentat e tenderit.

Neni 3 – Objekti i kontratës

3.1 Objekti i kesaj kontrate eshte sherbimi per realizimin e projekt zbatimit te plote per objektin :

Bashkia Durrës

2

AVE CONSULTING

“Projekt zbatim rruge paralel me murin rrethues te Portit”

Neni 4 – Çmimi i kontratës

- 4.1 Çmimi që i paguhet kontraktuesit për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të kontratës është Vlera 2'495'000 (dymilion e katerqind e nentedhjet e pese mije) leke pa tvsh dhe me tvsh 2'994'000 (dymilion e nenteqind e nentedhjet e kater mije) lekë
- 4.2 Çmimi perfshin te gjitha detyrimet fiskale qe parashikon legjislacioni shqiptar.

Neni 5 –Mënyra dhe afatet e Pagesës

- 5.1 Pagesa per sherbimin e projektimit do te behet si me poshte :
- Kontraktuesi do te paguhet me 60% te vleres totale te kontrates , **ne vleren 1'796'400 (njemilion e shtateqind e nentedhjet e gjashtemije e katerqind) leke**, ne momentin e dorezimit te projekt-zbatimit dhe te miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
 - Kontraktuesi do te paguhet me pjesen tjeter te vleres se kontrates te pa paguar prej 40% te vleres totale te saj , **ne vleren 1'197'600 (njemilion e njeqind e nentedhjet e shtate mije e gjashteqind) leke**, ne momentin e fillimit te zbatimit te projektit nga Autoriteti Kontraktues.
 - Ne rast se zbatimi i objektit nga Autoriteti Kontraktor nuk fillon brenda nje afati prej 365 ditesh kalendarike nga dita e dorezimit te projekt-zbatimit nga firma projektuese , atehere Autoriteti Kontraktor eshte i detyruar ti shlyeje Kontraktuesit pjesen prej 40% te projektit te pa paguar.
- 5.2 Pagesa do te behet me urdher xhirim prane Bankes _____, ne numrin e llogarise bankare te kontraktuesit nr. _____, sipas skedarit te paraqitur ne piken 5.1.
- 5.3 Pagesa per sherbimin e parashikuar ne piken 5.1 paragrafi pare te kesaj kontrate do te behet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 diteve kalendarike nga dita kur projekt zbatim eshte dorezuar dhe pranuar nga ana e tij.
- 5.4 Monedha e pagesës do të jetë monedha shqiptare (lekë) .

Neni 6– Afati i dorezimit te projektit

- 6.1 Projekti i zbatimit do te dorezohet nga shoqeria projektuese ne afat kohor prej 60 (gjashtedhjet) ditesh kalendarike nga dita e lidhjes se kontrates ne 3 (tre) kopje origjinale te kerkuara ne detyren e projektimit(aneks kontrate).
- 6.2 Kontraktuesi brenda afatit kohor te parashikuar duhet te paraqese sipas detyres se projektimit ne dokumentat e tenderit me propozimin teknike dhe ekonomike, te paraqitur nga Kontraktuesi ne tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor:
- Projekt-zbatimin
 - Specifikimet teknike sipas zerave te punimeve
 - Preventivin e plote sipas volumeve perfundimtare te punimeve
- 6.3 Projekti do te merret ne dorezim nga perfaqesues te Bashkise Durrës , te cilet do te verifikojne ate dhe do te leshojne aktin e marrjes ne dorezim te projektit.

Neni 7– Vonesa ne zbatim dhe zgjatja e afatit .

- 7.1 Me marrveshje me shkrim midis paleve, afati i dorezimit te projekt zbatimit mund te zgjatet
- 7.2 Ne rast se palet bien dakort te zgjasin e afatin e dorezimit te projektit ne ditën e fundit te dorezimit te projekt zbatimit, Autoriteti Kontraktor nuk do te aplikojë mbi Kontraktuesin kamat vonesa.
- 7.3 Kontraktuesi do të çlirohet nga përgjegjësia për moszbatimin e detyrimeve kontraktuale që vijnë si rezultat i forcës madhore. Nëse ndodh një situatë e tillë kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Autoritetin Kontraktor . Sipas rastit të veprimit të këtij fenomeni palët me marrëveshje e mirëkuptim përcaktojnë kushtet dhe afatet e reja praktikisht te arsyeshme per zbatimin e detyrimeve te kontrates.
- 7.4 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 8 – Likuidimi i demeve

- 8.1 Tarifa ditore për demet e likujdueshme per kryerjen e Sherbimeve përtej afatit 60 ditor do të jetë 4/1000 e vleres koresponduese te mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontrates por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25 perqind e vleres se saj.
- 8.2 Kamata e shperblimit per demet e shkaktuara si rezultat i voneses ne berjen e pageses perlllogaritet nga data e fillimit te voneses qe eshte 30 dite nga data e vertetuar per Autoriteti Kontraktor se sherbimi eshte kryer.

Neni 9– Te drejtat dhe detyrat e Kontraktuesit

- 9.1 Kontraktuesi do te hartojë projekt zbatimin ne tre kopje te barabarta dhe do ti dorezohet Autoritetit Kontraktor sic parashikohet ne kushtet e kesaj kontrate.
- 9.2 Kontraktuesi eshte detyruar t'i pergjigjet te gjitha kerkesave te Autoritetit Kontraktor , ne radhe te pare ne lidhje me cilesine e projektit, si dhe problemeve qe mund te dalin gjate zbatimit te projektit ne objekt.
- 9.3 Kontraktuesi eshte i detyruar te marre parasysh dhe te zbatoje te gjitha detyrat dhe udhezimet e lena nga Oponenti mbi projektin.
- 9.4 Kontraktuesi eshte i detyruar te marre ne konsiderate dhe te pasqyroje ne projektin e zbatimit te objektit te gjitha verejtjet qe mund te lihen nga KRT ne lidhje me projektin dhe preventivin.
- 9.5 Kontraktuesi nuk ka te drejte te jap projektin per perdorim apo shitje personave tjere te trete pa marre miratimin e Autoritetit Kontraktor, i cili ka te drejten e pronesisë mbi projektin e hartuar nga Kontraktuesi.
- 9.6 Kontraktuesi ka te drejte t'i kerkoje Autoritetit Kontraktues pagesen per projektin e hartuar prej tij ne perputhje me nenin 5 te kesaj kontrate.

Neni 10- Te drejtit dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues

- 10.1 Autoriteti Kontraktor ka te drejte ti kerkoje Kontraktuesit dorezimin e projekt-zbatimit brenda afatit te parashikuar ne kete kontrate.
- 10.2 Autoriteti Kontraktues ka te drejte ti kerkoje Kontraktuesit rishikimin e projektit ne rast se ai nuk i pergjigjet kerkesave teknike te parashikuara nga Autoriteti Kontraktues ne Dokumentat e tenderit.
- 10.3 Autoriteti Kontraktor ka te drejte ti kerkoje Kontraktuesit te rishikojë projektin dhe te jape mendime ne rast se gjate zbatimit te objektit dalin probleme qe kane te bejne me projektin.
- 10.4 Autoriteti kontraktor eshte i detyruar ti jape ne kohen e duhur Kontraktuesit informacionin e nevojshem qe ka ne dispozicion, me qellim realizimin e projektit.
- 10.5 Autoriteti Kontraktues eshte i detyruar te kryeje pagesen, per sherbimin e projektimit ne perputhje me nenin 5 te kesaj kontrate.

Neni 11 - Pronesia e projektit

- 11.1 Çdo gje e dhëne ose e paguar per projektin nga Autoriteti Kontraktues , si dhe vete projektin do te jene prone e Autoritetit Kontraktues (Bashkia Durres) si e tille do te konsiderohen kudo qe do te perdoren ato.

Neni 12- Zgjidhja e kontratës

- 12.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse :
 - Kontraktori dështon në kryerjen e sherbimit brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes se dhene; ose,
 - Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj kontrate.
- 12.2 Autoriteti kontraktor do ti japë kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe ti japë kontraktorit 15 ditë që të ndreqë mosplotësimin .
- 12.3 Të gjitha materialet, e perfunduara do te behen prone e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata nderpritet për mosplotësim te kushteve te saj.

Neni 13 - Sigurimi i kontratës

- 13.1 Shuma e sigurimit të kontratës prej 10 % të vlerës së kontratës do ti paguhet Autoritetit Kontraktor si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 13.2 Sigurimi i kotratës do ti kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës se dorezimit dhe pranimit te projektit nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 14.1 Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura në lidhje me këtë kontratë me mirëkuptim dhe negociata midis tyre.

14.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do ti drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës dhe problemet do të zgjidhen sipas procedurave juridike në fuqi dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë .

Neni 15- Dispozita të fundit

15.1 Palet merren vesh midis tyre vetem me shkrim ne adresen e specifikuar ne kontrate . Njoftimi do te kete efekt sapo te dorezohet.

15.2 Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dy palëve në gjashtë kopje, 1 (një) për Kontraktuesin dhe 5 (pese) për Autoritetin Kontraktor.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

AUTORITETI KONTRAKTOR


BASHKIA DURRËS


Vangjush **DAKO**
Kryetar i Bashkisë



KONTRAKTUESI

“AVE CONSULTING”


Arben **DERVISHAJ**
Administrator i shoqërisë



ANEKS- KONTRATE

“Projekt zbatim rruge paralel me murin rrethues te Portit”

Nr. References se Kontrates: BD.SH.K.16.09

TERMAT E REFERENCES

DETYRË PROJEKTIMI

Te pergjitheshme:

Ne vijim te realizimit te detyrave planit strategjik te zhvillimit dhe politikave urbane qe Bashkia Durres ka ne perparesi te saj, ka ardhur koha dhe shtrohet si detyre konceptimi i sistemit rrugor dhe i infrastruktures inxhinierike ne aksin rrugor paralel me murin e portit , i cili do te jete nje aks rrugor teresisht i ri , qe fillon nga intersektimi me rrugen “ Skenderbej “ prane BKT dhe duke ndjekur pergjithesisht nje paralele me rrethimin e portit do te lidhet me rrjetin rrugor ekzistues nacional dhe urban ne zonen jugore te mbikalimit te Ures se Dajlanit si dhe njekohesisht do te parashikohet vazhdimesia e tij per lidhjen me rrugen e re te zones se plazhit mbi kanalin kullues192, me nje gjatesi ~ 2.km.

AKSI rrugor paralel me rrethimin per me shume se ne 1/2 e tij eshte parashikuar si nje rruge e propozuar edhe ne Studimin e fundit Urbanistik te Qendres se Qytetit te Durrës duke e lidhur ate me rrjetin rrugor ekzistues,(rruga “ Skenderbej “) jo vetem ne pikat e siperpermendura por duke shtuar edhe disa nyje te tjera rrugore ndermjet zonave urbane tashme te formuara.

Duke qene se zhvillimi i qytetit cdo dite behet gjithnje e me vrullshem, nevojat e tij per levizjen dhe komunikimin e mjeteve jane renduar dhe sistemi rrugor aktual perballon me shume veshtiresi flukset e levizjes, vecanerisht ne momentet e pikut (stinet turistike) eshte menduar qe ne momentet aktuale te merren ne analize dhe te zgjidhen problemet e levizjes dhe te infrastruktures te zones duke e kthyer ate ne nje zone urbane te trajtuar dhe te unifikuar me sistemin rrugor ekzistues.

Plotesimi i interesave urbane dhe permiresimi i vazhdueshem i levizjes dhe komunikimit ne qytetin tone, ne referim te transformimeve te medha qe ka pesuar qyteti, me qellim menaxhimin sa me te mire dhe efektiv te territorit, harmonizimin e interesave publike ne pergjithesi me interesat e komunitetit te zones ne vecanti dhe jo vetem, ne sistemimin dhe disiplinimin urban te zones ne cilesine dhe parametrat e kerkesave te kohes, lehtesimin dhe permiresimin e trafikut dhe te infrastruktures inxhinierike perkatese [KUZ, KUB, etj], Bashkia Durres shfaq interesin, qe me fondet e akorduara nga buxheti i Bashkise te realizoje projekt – zbatimin e AKSIT rrugor te siperpermendur te pandare nga sistemimi i ujrave te zeza dhe disiplinimin e ujrave te bardha te zones.

Kjo zone e pare si pjese perberese e nje territori urban gjithnje ne transformim te vazhdueshem, nje pjese e te cilit tashme e ka krijuar fizionomine e vet urbane do te ishte me interes te trajtohej edhe si nje miniplan rregullues zonal, po te kihet parasysh se disa elemente te tij si ;

- projekt ideja e ketij segmenti
- zonifikimi altimetrik ,

tashme jane te miratuara nga autoriteti kompetent perkates.(KRRTRSH) ne STUDIMIN URBANISTIK TE QENDRES SE QYTETIT DURRES

Duke qene se ne kete territor nderthuren dhe duhet te harmonizohen interesate zhvillimit te portit te Duresit, aksesit hekurudhor qe duhet te kete ky port, autoret e projektit te marrin ne konsiderate pikeresht keto interesa dhe ne zgjidhjen teknike qe ata do te paraqesin ne projekt -zbatimin e ketij segmenti, te jene te pasqyruara edhe plotesimi i kerkeseva te ketyre institucioneve me rendesi jetike per vendin dhe qytetin. (Autoriteti Portual Durres dhe Hekurudha Shqiptare)

Departamenti i Urbanistikes ne vijim te porosive dhe urdherave te autoriteteve bashkiake, ne mbeshtetje te plote te bazes ligjore ne fuqi, nepermjet kesaj detyre projektimi deri ne fazen projekt zbatimi, te paraqitur si me poshte, ka parashtruar disa parametra teknike dhe urbane per te mundesuar realizimin e vepres ne kushtet bashkekohore te zhvillimit te nje qyteti modern me kosto optimale te domosdoshem duke patur ne konsiderate dhe ndertimin e plote sipas mundesive reale ekonomike te fondeve te disponueshme, gjithashtu dhe perparesive, e emergjencave qe shtron koha per permiresimin e vazhdueshem te cilesise se jeteses se komunitetit tone qytetar.

Duke patur tashme :

- nje situatë urbane teresisht te transformuar si nga ndertimet formale ashtu edhe ato informale
- nje projekt- ide te rrjetit rrugor te miratuar
- rrjet inekzistent tejet te sistemeve te kanalizimeve te ujrave te bardha dhe te zeza
- marredheniet e pronesise ndermjet institucioneve, por edhe raportin shtet - privat,

Kerkohet :

Projektimi i segmentit rrugor (AKSI 1) te zones se siperpermendur duke rishikuar dhe projekt idene miratuar ne bashkerendim te plote te interesave publike ndermjet institucioneve (Bashkia Durres – Autoriteti Portual – Hekurudha Shqiptare) dhe me ate privat ne marredheniet e pronesise, si dhe projektimi i sistemit KUZ dhe KUB te zones deri ne fazen PROJEKT-ZBATIMI.

PARAMETRAT TEKNIKE KRYESORE QE DO TE RESPEKTOJE PROJEKT-ZBATIMI I RRUGES

Gjeresia e brezit te kalimit per gjysmen e pare te ketij segmenti (nga B K T deri mbas parkingut te bashkise prane Stacionit te Trenave Durres) te jete 11m, shoqeruar me trotuare 3,5m .

Pjesa e dyte pas nje rakodimi brenda kushteve teknike dhe mudesive reale qe lejon territori te respektoje gjeresi te pranuar brenda standarteve te njohura , gjithnje e shoqeruar me trotuare nga 3,5m Pas trotuarit lindor te parashikohet muri rrethues i Portit, Intersektimet e segmentit rrugor me rrugen “Skenderbej” dhe te Ura e Dajlanit te zgjidhen sipas KTP per intersektimet ne nivel (rotonda). Te parashikohen Lidhjet e AKSIT TE RI me rrugen “ Skenderbej” ne keto pozicione :

1. te DP e Hekurudhave (b = 7m)
2. te kryqezimi ish local “ Danubi “ (b = 7m)
3. te kryqezimi i ish Magazines se Duhanit (objekti “ Blu Star”) (b=7m)
4. te kryqezimi i ish Fermentimit te Duhanit (objekti “ Flag Ship “)
(b = sipas mundesive)

5. te kryqezimi i ish peshores se vjeter (b = 10,5m)

6. te kryqezimi prane sheshit te trageteve
(b = sipas mundesive)

Rruga perimetrale e portit dhe aksesit hekurudhor portual me piknisje nga linjat ekzistuese te Ura e Dajlanit nuk eshte objekt i kesaj detyre, duke qene se trajtohet ne Master-Planin e portit

Prane Hyrjes 4 te portit te parashikohet nje territor disponibel me qellim realizimin ne te ardhmen nga Autoriteti Portual i skemes bashkohore te hyrjes, kontrollit, dhe perpunimit te mjeteve sipas kushteve te sigurise qe parashikohen ne protokollet perkatese (jo me pak se 45m * 45m)

Rruga te kompletohet me ndricim dhe gjelberim

• **Qellimi i kesaj detyre projektimi**

Te mundesoje hartimin e nje projekt-zbatimi (i cili nepermjet procedurave te prokurimeve do te shpallet perfundimtar dhe do te zbatohet sipas mundesive financiare) per segmentin rrugor dhe sistemet e KUZ dhe KUB, duke plotesuar kriteret bashkekohore te projektimit, duke ju pergjigjur dhe siguruar parametra teknike nga KTP dhe standartet bashkekohore, qe garantojne sot, dhe ne te ardhmen si intensitete te pritshme te mjeteve ne qarkullim ashtu dhe tonazhin e tyre per njesi mjeti. E barazvlefshme do te shprehej interesi edhe per zgjidhjen e projekt zbatimit per KUZ dhe KUB.

• **TE DHENA TEKNIKE ME KARAKTER TE PERGJITHSEM**

Pozicioni gjeografik i zones

Segmenti i siperpermendur shtrihet kryesisht ne lindje te qytetit tradicional te Durresit, thuasje paralel me rrethimin aktual te portit, me kufizime te pergjithshme (si referenca te sakesuara) fillimi nga BKT ne rrugen "Skenderbej" dhe perfundimi te Mbikalimi i Ures se Dajlanit. Nga pikepamja administrative kjo zone eshte pjese e Lagjes 3 - 4 - 17, ne perberje te Rajonit Nr 1 dhe 5, nga me te medhate njesi administrative te Bashkise Durres.

Ndarja dhe emertimi zonal eshte si me poshte :

(referuar toponimise se vjeter por edhe asaj aktuale)

Zona 1 : BKT - Stacioni i trenave

Zona 2 : Stacioni i trenave - Ura e Dajlanit

Situata urbane aktuale e zones

Nga pikepamja urbane zona ne teresi vecon dy teritore te medha me karakteristikat e tyre perkatese:

Zona 1 : Eshte zona lindore e qytetit tradicional me nje status urban pergjithesisht te formuar, pergjithsisht me ndertime te paraviteve '90 kryesisht 6 - 7 kat por pergjate kesaj vije ndertimi shquhen edhe ndertimet te mevoneshme me lartesi 8 - 10 - 12 kate. Ne hapësirën territoriale nermjet godinave dhe rrethimit te portit (kryesisht me fragmente linjash hekurudhore jashte funksioni, te trasheguara qe nga koha e stacionit te vjeter te trenave (sot DPH) ka patur pak tendenca te ndertimeve informale, te cilat kryesisht jane te karakterit te perkohshem te tipit (barake, ndertim me blloqe dhe deri ne 1 kat se bashku me rrethime e tyre. Kryesisht territori ku mendohet te trasohet aksi i kerkuar eshte pergjithesisht i lire me perjashtim trashegimit te linjave hekurudhore teresisht te degraduara. si nje territor pa nje juridiksion te percaktuar shpesh esht perdorur edhe si vend depozitimi i mbeturinave te ndertmeve te ndryshme e ndihmuar kjo dhe per faktin se ende ndodhen garnitura vagonesh

jashte funksioni.

Zona 2 : Eshte nje teritor i situacionuar ndermjet linjave hekurudhore funksionale qe hyjne ne qytet dhe ne Port dhe vete rrethimit te Portit. Me perjashtim te disa ndertimeve te vogla informale prane Ures se Dajlanit , territori eshte i lire por ne pika te vecanta ku mendohet te intersektoje si rrethimin ashtu edhe hekurudhen do te parashikohen zhvendosjet respektive

RRJETI RRUGOR

Ne zonat e siperpermendura rrjeti rrugor eshte inekzistent me perjashtim te atyre rrugeve te brendeshme qe lidhin blloqet e banimit me rrugen " Skenderbej " dhe te gjitha perfundojne si rrugica pa krye. Si u pemend edhe ne lart ne zonen 1 shquhen aty ketu linja hekurudhore te ish stacionit te vjeter ndersa ne zonen 2 jane linjat hekurudhore funksionale te qytetit dhe portit

MARREDHENIET MBI PRONEN

Mbas viteve 1990, sic eshte edhe e njohur, maredheniet e pronesise, kane ndryshuar duke duke krijuar raportin e ri Shtet-Privat. Ne respektim te te gjitha parametrave tekniko-social, kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit, duke patur ne konsiderate investimet publike te ketij segmenti rrugor , se bashku me infrastrukturane perkatese, do te ishte me vend te theksohej qe aksi rrugor te respektoje pronen private duke u zhvilluar kryesisht ne prona publike, pasi shpronosimi per inters publik do te rendonte koston e vepres ne menyre te ndjeshme. (perjashtim behet aty ku eshte e domosdoshme).

Studio Projektuese me informacion nga ZRPP pregatit dhe propozon Planimetrine e shpronosimeve

MORFOLOGJIA-GJEOLOGJIA-BIMESIA-KLIMA

Territori eshte teresisht nje terren i ulet dhe i rafshet fushor,ne karakteristikat me te pergjitheshme gjeo-morfologjike te ultesires bregdetare, tipike natyren e ketij lloji, me lartesi mesatare nga niveli i detit 2-3m.

Nga pikpamja gjeologjike territori ne shtresa siperfaqesore perbehet ranore te perziera me argjila,ku pergjitheshish mbizoterojne formacionet ranore. Niveli i ujrave nentokesore te saktosohet nga studimi gjeologo – inxhinierik perkates.

Pjerresite natyrale si dhe transformimet urbane nuk garantojne kullimin natyral te zones, vecanerisht ne stinen e dimrit

Bimesia natyrale eshte ajo karakteristike per zonen e brezit mesdhetar te ku vecohen shkurret lagunore, pisha e bute, plepi dhe bimet ranore.

Klima eshte karakteristike mesdhetare me vere te nxehte dhe te thate dhe dimer te bute dhe me lageshti.

| | |
|------------------------------|----------|
| Temperatura mesatare vjetore | 15,5 °C |
| " " gusht | 24 °C |
| " " janar | 7 °C |
| Rreshjet : | |
| Mesatare vjetore | 963 mm |
| Maksimale vjetore | 1542 mm |
| Mimimale vjetore | 637 mm |
| Diellezimi : | |
| Ore me diell ne vit | 2786 ore |

Era dhe ndikimi i saj: Trendafili i ererave

Shpejtesia e eres varion sipas muajve nga 24m/sek -40m/sek

Drejtimi mbizoterues Veri- juglindje, perendim, puhi detare

INFRASTRUKTURAT, NDRICIMI, GJELBERIMI

Disiplinimi i ujrave siperfaqsores (kullimi). Nga vete karakteristikat gjeomorfologjike te terrenit kullimi i siperfaqeve te kesaj zone i eshte nenshtuar vete rrjedhjeve nayrore pasi ne teresi zona nuk gezon disiplinim te ujrave siperfaqsores. Ne keto zona vlen te permendet rrjeti i furnizimit me energji i portit dhe sistemi i sinjalizimit te hekurudhes. Prane rrethimit te portit jane instalimet e rrjetit kabllor portual

Sistemi i kanalizimeve te UJRAVE TE ZEZA Ne territoret ku mendohet te kaloje aksi rrugor sistemi i KUZ eshte inekzistent

Ndricimi dhe gjelberimi Nuk ka informacion per rrjetin elektrik ne funksionim ose jo qe mund te kete sherbyer per hekurudhen

Objektivat dhe problemet qe do te zgjidhe projekti

Duke u nisur nga kendveshtrimi i nje rikonceptimi bashkekohor te arterieve te sistemit rrugor te kesaj zone, te parashikohet trasimi i aksit dhe parametrat e rruges konform kushteve teknike te projektimit dhe standarteve qe kerkon koha.

- Me qellim realizimin e mireadministrimit te territorit dhe harmonizimin e interesave te tre institucioneve (Bashki – Autoriteti Portual – Hekurudha) nepermjet nje studimi te pjesshem zonal, te hartoje deri ne projekt - zbatim trasimin e AKSIT te ri dhe te nyjeve lidhese prane kryqezimeve me akset kryesore intersektuese, dhe njekohesisht edhe me studimet e miratuara apo perspektive ne keta pozicione, me kriter disiplinimin e trafikut ne parametrat bashkekohore te levizjes ne zona urbane.
- Duke patur ne konsiderate disiplinimin dhe kullimin sa me optimal te ujrave siperfaqsores, te parashikojte niveletat e rruges duke bere rakordimet e domosdoshme ne pozicionet e disniveleve ne kryqezime, duke ruajtur aty ku eshte e mundeshme nenstrukturat ekzistuese dhe duke siguruar lidhjen e domosdoshme ndermjet shtresave ekzistuese dhe materialeve mbushese. Shtresat dhe nenstruktura rrugore te perballojne kushtet e nje trafiku te renduar si ne qarkullim ashtu edhe ne tonazh.
- Te parashikohet permiresimi i infrastruktures dhe zhvendosjet e duhura te saj per shkak te zgjerimit, vecanerisht asaj te kullimit te zones (disiplinimi i ujrave siperfaqsores), dhe kompletimi ne teresi i asaj te munguar (kryesisht ujrat e zeza) deri ne fazen e projekt - zbatim.
- Te parashikojte prerjet terhoore tip te rruges te aksit kryesor dhe rrugeve lidhese, sipas kerkesave ne parametrat teknike kryesore, por mundesive reale qe lejon territorri. E barazvlefshme edhe per trotuaret
- Te parashikojte ne projekt - zbatim, ndricimin rrugor ne aksin e rruges ose jo me shtylla metalike (tipi per ndricim rrugor ne varesi nga prerja terhoore e rruges per pozicionin e caktuar) Ndricimi anesor (ose i trotuareve) te kenaqe kerkesat e nje ndricimi dekorativ qytetes.
- Te parashikojte vendet e depozitimeve te mbeturinave te ngurta te aktiviteteve te ndryshme si dhe menyren e evadimit te tyre.(kazanat e plehrave)

- Te parashikojë gjelberimin e lartë me llojin dhe frekuencën e pemeve të pershtatshme për klimën dhe natyrën e qytetit të tyre.
- Te parashikojë disiplinimin e trafikut në kryqezime me semafore dhe sinjalistike
- Te parashikojë një korsë ciklistike me gjeresi optimale sipas mundësive reale
- Te marrë në konsideratë për të gjitha pozicionimet e realizimit të veprës më të mirë mbi pronësinë.

Termat e referencës janë të barazvlefshme edhe për projekt zbatimin e KUZ dhe KUB si dhe Ndricimin, Gjelberimin dhe Sinjalistikën rrugore

Konform kërkesave të rregullores së Urbanistikës dhe Kzushëve Teknike të Projektimit të rrugëve urbane

- Projekt zbatimi i aksëve rrugorë të hartohet mbi relievin faktik të zonës në sh. 1:500. Sistemi koordinativ dhe altimetrik i referimit mund të zgjidhen edhe relative, por detyrimisht të jenë të lidhur me objekte kapitale. Fiksimi i pikave poligonale dhe reperave, të bëhet në mënyrë të përhershme dhe të shoqërohen me monografitë përkatëse. (Ky sistem do të mund të shërbejë edhe për punimet e zbatimit)
- Planimetritë e rrugës dhe të sistemit të kanalizimeve në sh. 1 : 500 gjatë gjithë gjatësisë së kërkuar ku të jepën këto të dhëna teknike:
Koordinatat e aksit të rrugës (dhe kanaleve) nga poligonet e rievimit ose pozicionet e tyre planimetrike, të përcaktohen me referencë distancash nga objekte kapitale të ndërtuara përgjatë rrugës (ose bordura ekzistuese)
Kuotat e rrugës (dhe kanaleve pusetave) për pozicionet ku thyhet niveleta (kuota e projektit)
Përresitë dhe distancat pjesore të segmentit rrugor si dhe kilometrazhi (referimi fillestar i gjatësisë së rrugës 0+00m, 0+100, etj)
Pozicioni planimetrik (koordinativ ose me referim nga objekte ekzistues) i vertekseve, elementet kryesore të kthesave (nëse ka) dhe detajet për zbatimin e rrugës në plan dhe lartësi)
Izoipset e projektit të rrugës (plani i kullimit të ujërave të vetë rrugës, shimbledhës, kuletat).
Vija e ndërtimit ekzistues dhe vija e ndërtimit në perspektivë (zona – brezi rrezeve).
Evidentimi i tombinove ekzistuese, për kullimin e zonës, rikonstrukcioni apo ndërtimi i të reja aty ku mungojnë (tipi dhe detajet në fletë të vecanta)
Evidentimi i infrastruktures ekzistuese (kanalizime, elektrike, telefoni, ujësjelles) dhe parashikimi i projekt zbatimit të ndërtimit të tyre (për ato që do të zhvendosen).
Ndricimi dhe gjelberimi të parashikohen për fazë projekt-zbatim.
Të përcaktohen vend depozitimet e mbeturinave urbane (kazanet e plehrave).
Të parashikohen edhe mundësitë reale vend parkimi mjedesh.
Projekti të paraqesë në mënyrë të detajuar sinjalistikën dhe disiplinimin e trafikut në nyjet rrugore
Shënim : Për të mos e mbingarkuar informacionin në një fletë të vetme, Planimetria e rrugës mund të ndahet në disa nën emertesa si (Planimetria e Përgjithëshme e rrugës, Planimetria e shimbledhësave dhe kullimeve, Planimetri e parkimeve dhe vend grumbullimi i plehrave, planimetria e gjelberimit – ndricimit, planimetria e sinjalistikës rrugore etj, Planimetria e kanalizimeve, pusetave të kontrollit, kryqezimeve, etj)

- Planimetria e shprehësiveve sh. 1 : 500 (nëse ka)

- **Profili gjatesor i rruges** te hartohet ne SH Hz 1: 1000 dhe SH V 1:100 duhet te paraqese:
 - Profilin e tokes (kuotat e tokes)
 - Vijen e projektit (kuotat e projektit) [Per kanalizimin kuotat e rrjedhes se ujit]
 - Pjerresite gjatesore te projektit
 - Piketazhin (nr i piketes)
 - Distancat pjesore
 - Distanca progresive
 - Kilometrazhi
 - Situacionin
 - Elemente te kurbave vertikale.

- **Profilat terthore** hartohen ne Sh 1:100 dhe duhet te paraqesin:
 - Frekuenca e profilave terthore cdo 25-40m (si dhe cdo pozicion ku veprat e artit apo infrastruktura nderpret aksin e rruges) Profili i tokes (me nje gjeresi te tille ku te paraqiten te plote muret rrethuese dhe konturet ndertimeve qe fasadojne me gjurmen e rruges dhe linjat hekurudhore pergjate saj , etj ~ 50 m)
 - Profili i rruges (vija e projektit me nje pjerresi terthore sipas KTP per shtresen e zgjedhur).
 - Kuotat e tokes dhe te projektit ne aks dhe ne gjurmen e projektuar.
 - Siperfaqet germim – mbushje
 - Tabelat e volumeve te punes
- Detajet e shtresave te rruges dhe bordurave
- Hollesi teknike te zbatimit te rrugeve dhe kanaleve
- Relacion teknik permbledhes
- Garancia , jetegjatesia dhe kondicionet e mirmbajtjes se vepres
- Plan organizimi i punimeve te zbatimit
- Grafiku i punimeve te zbatimit
- Parashikimi i kosos se vepres
- Flete prezantuese

Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në tre kopje, në gjuhën shqipe. Projekti do te hartohet dhe paraqitet ne format A3 ose shumefisha te tij, (kryesisht per planimetrite dhe profilin gjatesor ne A0) ne 3 kopje, me printime nga informacioni teresisht i dixhitalizuar ne file-s dwg (autocad). Kopja elektronike e projektit eshte pjese perberese e dokumentacionit teknik te dorezuar.

Dorezimi do te behet prane njesise se prokurimit
 Depozitimi i tij do te behet prane Sekretarise Teknike te Departamentit te Urbanistikes te Bashkise Durres.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me Rrugen
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Durres, seksioni i Urbanistikes dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të kihen parasysh edhe standarte të ndryshme që ka nxjerrë Bashkia Durres, siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesave e të tjera të kësaj natyre.

- Cilësia e studim-projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi.

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Llogaritjet statike te strukturave.
- Raportin teknik, ku përveç llogaritjeve të sipërpërmendura, do të jepen llogaritjet e shtresave, të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen egzistuese, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në rrugë dhe masat që duhet të merren për rregullimin e trafikut gjate punimeve të ndërtimit, Specifikimet Teknike për ç'do zë pune.
- Preventivi do te bazohet ne cmimet mesatare qe disponon Bashkia Durres per cdo ze pune dhe duke u bazuar ne cmimet reale te tregut.

SOQARIME TË FUNDIT

Të dhënat e nevojshme për projektim sic jane, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës etj. do t'i bashkangjiten këtij projekti.

Projekti do te hartohet dhe paraqitet ne format A3 ose shumefisha te tij, (kryesisht per planimetritë dhe profilin gjatesor ne A0) ne 3 kopje, me printime nga informacioni teresisht i dixhitalizuar ne file-s PDF.

Kopja elektronike e projektit eshte pjese perberese e dokumentacionit teknik te dorezuar.

Dorezimi do te behet prane Bashkise Durres.

Depozitimi i tij do te behet prane Sekretarise Teknike te Departamentit te Urbanistikes te Bashkise Durres.

AUTORITETI KONTRAKTOR

Bashkia Durrës

Vangjush **DAKO**
Kryetar i Bashkise



KONTRAKTUESI

“AVE CONSULTING”

Arben Dervishaj
Arben **DERVISHAJ**
Administrator i shoqërisë

